



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 39.
Prishtinë, më 26.04.2012 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Petar Miletic, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj

Mungon: Elmi Reçica, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic dhe Mufera Sinik.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësueset e OSB-së Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësues të KDI-së Shkumbim Beqiri, përfaqësues të KKK Veton Berisha dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Koordinatorë Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë e fushës, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-92 për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër, me raportin e komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, me amendamente
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore nr. L-67/1, me raportin e komisionit, FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente
4. Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit kundër Diskriminimit.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-92 për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër, me raportin e komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, me amendamente

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-92 për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit FunkSIONAL.

Pasi nuk kishte vërejtje Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-92 për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore nr. L-67/1, me raportin e komisionit, FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor me amendamente

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore nr. L-67/1, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit FunkSIONAL.

Pasi nuk kishte vërejtje Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore nr. L-67/1 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit kundër Diskriminimit.

Kryesuesi, theksoi se e komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione është në procedurë të monitorimit të Ligjit kundër Diskriminimit. Kryetarja e këtij komisioni ka propozuar që të zgjerohet grupi punues me përfaqësues të të gjitha komuniteteve.

Ai tha se është anëtar i grupit punues së bashku me Elmi Reçica dhe Albert Kinolli ndërsa kërkoi nga komisioni që të plotësohet grupi punues edhe me një anëtar të komuniteteve tjera.

Kryesuesi konstatoi se për plotësim të anëtarit të grupit punues, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për Komunitete dhe Kthim, në procedurën e monitorimit të Ligjit kundër Diskriminimit, për anëtarë të grupin punues ka emëruar Rasim Demirin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic